



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AL-Tec" Sh.P.K. të datës 10.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133-Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. të prokurimit 616-24-1368-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AL-Tec" Sh.P.K. e datës 06.06.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133-Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. të prokurimit 616-24-1368-1-1-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 06.06.2023 i autoritetit kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.
- II. **NJOFTOHEN** të gjitha palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "AL-Tec" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 10.06.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.06.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "133-Pikat ushqyese për qentë endacak (furnizimi dhe shpërndarja e ushqimit) dhe QTE" me nr. të prokurimit 616-24-1368-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

**P.1** - *“Operatori ekonomik nuk ka ne certifikate te biznesit asnje aktivitet per te ofruar njohuri rreth ushqimit te kafsheve”.*

**P.2.** - *“Referencat e operatorit ekonomik ofrojn deshmi te pjeserishme, mungon pjesa e e ndjeshme per pervojen ne ushqyerjen e qenve endacak. Qasja ndaj qenve endacak kerkon njohuri dhe pervoje rreth angazhimeve per te kryer detyra te ndryshme (gjithmon sipas legjislacionit në fuqi), duke u fokusuar ne menyren e sjelljes dhe qasjes ndaj tyre, njohuri kjo e cila kontibon ne parandalimin e rreziqeve (agresioni, transmetimi i sëmundjes ose lëndimet) që qeni mund t'i paraqesë komunitetit, kafshëve të tjera ose mjedisit”.*

**P.3.** - *“Thuhet kontrata ne shumes dhe jo kontrate njejes, OE I shpallur fitues ka ofruar si deshmi vetem nje kontrate te natyres se ngjajshme Citohet nga dosja e tenderit: Nje liste te kontratave te realizuara, pra nuk thuhet listen me se paku nje kontrate te realizuar”.*

**P.4.** - *“Operatori Ekonomik i shpallur fitues, nuk ka ofruar asnje deshmi apo dokumentacion duke ju referuar specifikimeve teknike te detyrueshme: nuk ka ofruar pershkrim te produktit te kerkuar, - Nuk ka ofruar asnje deshmi rreth paketimit te kerkuar dhe - Nuk e ka prezantuar produktin me katalog, sic kerkohet tek specifikimet teknike te detyrueshme”.*

Fillimisht duhet sqaruar se asnjë nga pretendimet ankimore nuk i referohet kërkesave përkatëse në dosjen e tenderit. Parashtruesi vazhdimisht i referohet disa dispozitave të LPP mirëpo me rastin e formulimit të pretendimeve ankimore nuk ka sqaruar se cila kërkesë e dosjes së tenderit pretendon që nuk është përmbushur nga tenderuesi i rekomanduar dhe mbi bazën e cilave argumente.

**P.1.** - Sidoqoftë, sa i përket pikës së pretendimit ankimor se tenderuesi i rekomanduar nuk ka certifikatë të biznesit, vlen të theksohet që në dosjen e tenderit është kërkuar që tenderuesit të dorëzojnë si dëshmi certifikatën e biznesit. Kjo kërkesë është përmbushur nga tenderuesi i rekomanduar në momentin që ka dorëzuar certifikatën e biznesit. Sa i përket kodit të veprimtarisë “njohuri rreth ushqimit të kafshëve” që e pretendon parashtruesi, duhet cekur se një kod i tillë sipas NACE nuk ekziston fare prandaj një kod të tillë nuk e posedon as parashtruesi por as tenderuesi i rekomanduar dhe asnjë biznes tjetër i regjistruar në RKS. Prandaj kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar.

**P.2.** - Sa i përket pretendimit ankimor për referencat e tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit është që listës së kontratave ti bashkangjiten edhe referencat përkatëse për realizimin e kontratave përkatëse sipas listës. Këto dokumente janë bashkangjitur në ofertën e tenderuesit të rekomanduar. Prandaj edhe kjo kërkesë e dosjes së tenderit është përmbushur me sukses ndërsa pretendimi është i pabazuar.

**P.3.** - Sa i përket pretendimit se është paraqitur vetëm një kontratë në listën e kontratave, duhet cekur se në dosjen e tenderit nuk është specifikuar se sa kontratave duhet të evidentohen në listë. Përderisa nuk është cekur numri i kontratave në dosjen e tenderit, mjafton që në listë të evidentohet 1 ose më shumë kontrata. Sidoqoftë tenderuesi i rekomanduar në listën e vet ka evidentuar gjithsej 8 kontrata për të cilat ka bashkangjitur dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas dosjes s tenderit. Prandaj edhe ky pretendim është pa bazë.

**P.4.** - Sa i përket pretendimit ankimor ku thuhet se "nuk ka ofruar asnje deshmi apo dokumentacion duke ju referuar specifikimeve teknike te detyrueshme: nuk ka ofruar pershkrim te produktit te kerkuar, - Nuk ka ofruar asnje deshmi rreth paketimit te kerkuar dhe - Nuk e ka prezantuar produktin me katalog, sic kerkohet tek specifikimet teknike te detyrueshme", duhet sqaruar se në specifikacionin teknik sipas aneksit 1 të dosjes së tenderit është përcaktuar si në vijim:

### **Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

**Specifikat e ushqimit:**

**Vlerat ushqyese:**

- a. Proteina të përgjithshme, min 26%. prej tyre proteina me përbajtje shtazore mbi 70%
- b. Yndyra Min 14%
- c. Produkti duhet të përmbajë mish të shpendeve dhe mish të gjedhit, Omega 3 dhe Omega 6
- d. Paketimi i ushqimit duhet të jete PET/MET/PE ne mënyre që të ruhen vlera ushqyese, aroma dhe kualiteti i ushqimit
- e. Përbajtja e ushqimit duhet të prezantohet me Katalogë nga prodhuesi si dhe përshkrim të specifikuar.

Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia për 1 ( një ) vit
1	Furnizimi, transporti dhe shpërndarja e ushqimit në 24 pikat ushqyese	kg	43800
2	Furnizimi dhe transporti I ushqimit për Strehimoren për qentë endacak	kg	25000

Në ofertën e tenderuesit të rekomanduar nuk është bashkangjitur katalogu i prodhuesit për produktet sipas specifikacionit teknik të detyrueshëm nga aneksi 1 i dosjes së tenderit. Në anën tjetër në specifikacionin teknik aneksi 1 thuhet shprehimisht se "përbajtja e ushqimit duhet të prezantohet me katalogë nga prodhuesi si dhe përshkrim të specifikuar". Prandaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij ankimore me nr. 4 mirëpo jo edhe 3 pretendimet tjera ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar vetëm si pjesërisht e bazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 21.06.2024**

**Visar SHEHU**

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.